



Projekti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 5744 Prot.

Lezhë, më 4 5 .2026

URDHËR

Nr. 303, Datë 4 . 5 . 2026

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR
PROJEKT-PRIORITETET E INVESTIMEVE 2027-2029 SI DHE NIVELIN E
TAKSAVE DHE TARIFAVE”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Vendimin Nr.393 datë 18.07.2022 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë” si dhe Vendimin Nr.27, datë 12.01.2026 “Për miratimin e Planit Vjetor 2026 të Kalendarit të Konsultimeve Publike për Bashkinë Lezhë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e kalendarit të konsultimeve publike për projekt-prioritetet e investimeve 2027-2029 si dhe nivelin e taksave dhe tarifave, për të gjitha njësitë administrative në Bashkinë Lezhë.
2. Konsultimet do të realizohen sipas kalendarit bashkëngjitur, në koordinim me Këshillin e Bashkisë Lezhë.
3. Të ngarkohet Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Emigracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës për koordinimin e procesit të konsultimit dhe informimit rreth takimeve si dhe transparencës për publikun.
4. Të ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit si dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për mbajtjen e procesverbaleve të takimeve si drejtori përgjegjëse për hartimin e projekt-akteve si dhe mbajtjen e listëprezencës.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Pjerin Ndreu

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV.KRYETARI
Brikena Vuksani



KALENDARI I KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PROJEKT-PRIORITETET E INVESTIMEVE 2027-2029 SI DHË NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE

Nr.	Aktiviteti	Objekti i takimit, konsultimit publik	Data	Vendi	Ora	Mënyra
1.	Konsultim publik me -banorë të njësive administrative Balldre, Dajç, Blinisht, Kallmet, Ungrej, Zejmen, Shënkoll, Kolsh. Shëngjin, Lezhë. -biznese lokale, -gazetarë dhe media lokale, - organizata të shoqërisë civile, grupe tjera të interesit.	Projekt-prioritetet e investimeve 2027-2029 si dhe niveli i taksave dhe tarifave.	29.05.2026	Pallati i Kulturës “Ded Ndue Lazri”, Lezhë	11:00	Takim publik

Rekomandimet për projekt-aktin që do të konsultohet mund t'i dërgoni në adresën e emailit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik në Bashkinë Lezhë gjystina.nikulaj@lezha.gov.al si dhe në adresën e sekretares së Këshillit të Bashkisë Lezhë florida.cunaj@lezha.gov.al deri me datë 29.05.2026.